



EUROPEAN YOUTH AWARD

ICNM - International Center for New Media
Leopoldskronstrasse 30, 5020 Salzburg, Austria
+43.660 63 04 082 | kolb@icnm.net

www.eu-youthaward.org

<http://www.facebook.com/EuropeanYouthAward>

<http://www.twitter.com/eyagraz> | #EYA17

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Përtej Google dhe Facebook: Forumi i Ekspertëve Digjital EYA17 – Përsosmëria Digjitale për Ndikim Shoqëror do të përzgjidhet në Prishtinë, Kosovë

Prej 28 – 30 shtator, 25 [Ekspertë të Jurisë së Madhe](#) ndërkombëtare do të përzgjedhin Fituesit e #EYA17 – Projektet më të shquara digjitale të Evropës që bëjnë ndryshime shoqërore – në Prishtinë, Kosovë. Për më tepër, ata do të ndajnë njohuritë dhe përvojën e tyre me profesionistët e rinj lokalë, bizneset e reja dhe sipërmarrësit gjatë Forumit të hapur të Ekspertëve Digjital.

Përtej Google dhe Facebook: [European Youth Award](#) (EYA) (Çmimi i Rinisë Evropiane) është një konkurs dhe platformë për inovacion, përsosmëri dhe ndikim shoqëror në hapësirën ndërvepruese digjitale. Ai paraqet atë që bëhet në mënyrë kreative dhe me ndikim në të gjitha skajet e Evropës.

Në takimin në Prishtinë – një qytet i shquar dhe i gjallë me shumë talent të rinj të jashtëzakonshëm dhe kreativë – Juria e #EYA17 do të marrë vendimet përfundimtare. Nga 144 aplikacione për EYA2017, 52 projekte kanë kaluar në rundin final. Në procesin e diskutimit dyditor, Juria e Madhe në terren e përbërë nga 25 ekspertë ndërkombëtarë të disiplinave të ndryshme do të kërkojnë projektet më të mira digjitale që prekin problemet e jetës reale në [8 kategori të ndryshme](#) që pasqyrojnë sfidat shoqërore.

Me 29 shtator, herët në mëngjes, në [Qendrën e Inovacionit të Kosovës](#) (ICK) do të mbahet Forumi i Ekspertëve Digjital mbi inovacionin digjital, potencialin e bizneseve të reja dhe teknologjitë e ardhshme të qëndrueshme me ndikim shoqëror. [Ekspertët e Jurisë](#) do të ndajnë përvojat dhe mendimet e tyre. ICK dhe EYA ftojnë të gjithë të rinjtë e etur për të mësuar që të shfrytëzojnë këtë mundësi unike.

"Ndërtimi i një rrjeti ndërkombëtar dhe mësimi nga njerëzit me sfonde të ndryshme kulturore dhe arsimore është përparësi e rëndësishme për sukses. Anëtarët e Jurisë së EYA-s shquhen për njohuritë e tyre rreth inovacionit aktual digjital dhe shoqëror dhe për angazhimet e tyre ngjithëse dhe frymëzuese," tha Peter A. Bruck, nismëtari dhe organizatori i Çmimit të Rinisë Evropiane.

Fituesit e #EYA17 do t'i prezantojnë iniciativat e tyre të dalluara digjitale në [Festivalin e EYA](#) (Takimi i Fituesve) që zhvillohet në Grac prej 29 nëntorit deri më 2 dhjetor. Kjo ngjarje e rrjetëzimit, njohurive dhe frymëzimit është e dizajnuar për njerëzit që bëjnë ndryshime digjitale dhe shoqërore dhe për të gjithë të interesuarit për përmirësimin e shoqërisë me teknologjitë digjitale.

**Për më shumë informacione ju lutem kontaktoni:
Kathrin Quatember, +43.660 63 04 085 | quatember@icnm.net**

Info e shpejtë për Forumin e Ekspertëve Digjitalë:

Data: 29 shtator, 09:30 – 12:30
Vendi: Qendra e Inovacionit të Kosovës, Rr. Rexhep Mala 28A, 10 000 Prishtinë
Biletat: pa pagesë vetëm me regjistrim
<https://eu-youthaward.org/expert-forum-registration/>

Me përkrahjen e:





EUROPEAN YOUTH AWARD

ICNM - International Center for New Media
Leopoldskronstrasse 30, 5020 Salzburg, Austria
+43.660 63 04 082 | kolb@icnm.net

www.eu-youthaward.org

<http://www.facebook.com/EuropeanYouthAward>

<http://www.twitter.com/eyagraz> | #EYA17

Për European Youth Award (EYA)

I krijuar nga prof. Peter A. Bruck, kryesues nderi i Qendrës Ndërkombëtare për Mediat e Reja në vitin 2012, Çmimi i Rinisë Evropiane (EYA) është konkursi kryesor pan-evropian që nderon përsosmërinë në përdorimin e Internetit dhe aplikacioneve mobile për fuqizimin shoqëror. I zhvilluar nën patronatin e Këshillit të Evropës dhe Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale, EYA është një konkurs vjetor që motivon të rinjtë nën moshën 33 vjeçare që të hartojnë projekte digjitale me vlerë shoqërore që adresojnë qëllimet e përcaktuara nga Këshilli i Evropës, Evropa 2020 dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së.